



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.86, datë 18.06.2024

PËR
VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË ZOTIT MIRJON BRAHIMLLARI,
KANDIDAT PËR MAGJISTRAT PROKUROR, I CILI DO TË DIPLOMOHET NGA
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2024

Mbështetur në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159 dhe 189 pika 1, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 35 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për magjistrat prokuror zotit Mirjon Brahimllari, i cili do të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2024”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit të kandidatit për t’u emëruar prokuror, zoti Mirjon Brahimllari, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit Mirjon Brahimllari.
3. Lejimin e kandidatit Mirjon Brahimllari të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e tij si prokuror.
4. Të njoftohet për këtë vendim zoti Mirjon Brahimllari dhe Shkolla e Magjistraturës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 18.06.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka



ANËTAR
Olger Eminaj

